



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Tafaj
Gramoz
Ruci

Nr. 3972

19.12.2018

Lënda: Amendament për projektligjin “Për Kadastrën”.

DREJTUAR: **Z. Gramoz RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

BAZA LIGJORE: Rregullorja e Kuvendit, neni 75, pika 4.

I nderuar zoti Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, propozoj që në projektligjin “Për Kadastrën” të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Në **nenin 5**, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Parimi i sigurisë juridike: Respektimi i të drejtave të fituara më parë dhe i pritshmërive të ligjshme të subjekteve të së drejtës.”

Në **nenin 7**, pika 3, togfjalëshi “i cili është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues”, hiqet.

Në **nenin 8**, bëhen këto ndryshime:

“Në pikën 1, në fjalinë e parë, togfjalëshi “një prej të cilëve është Drejtori i Përgjithshëm”, hiqet.

Në pikën 1, në fjalinë e dytë, togfjalëshi “tjerë të” hiqet.

Në pikën 1, pas gërmes dh), shtohet gërma e) me përmbajtjen si më poshtë:

“e) Një përfaqësues nga ASHK.

Në pikën 3, fjalia “Kyetari i Këshillit Drejtues nuk mund të jetë njëkohësisht edhe Drejtor i Përgjithshëm”, hiqet”.

DEPUTET

VASILIKA HYSI

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized, overlapping loops and a long horizontal stroke extending to the right.